

# GLOBALIZIMI DHE KËRCNIMET GLOBALE: SFIDAT PËR MENAXHIMIN E PANDEMIVE NË SHEKULLIN 21

**Nevruz Zogu<sup>1</sup> Shpetim Reznici<sup>2</sup>**

Kolegji Universitar "BENZESI"

## **Abstract**

Shumë nga aspektët e globalizimit ndërlidhen dhe kështu rriten<sup>1</sup> rreziqet për një sërë kërcënimesh ndërkombëtare që nga prodhimi i armëve, pirateria në internet, dhuna etnike, krimi global, trafiku i drogës, degradimi i mjedisit dhe përhapja e sëmundjeve ngjitëse. Cfarë strategjish dhe veprimesh duhet të ndiqen për tu përballur me to? Teknologjitë e informacionit dhe sistemeve janë tiparet kryesore të globalizimit dhe janë bërë thelbësore për funksionimin e shumë sistemeve civile të rëndësishme si komunikimi, energjia, transporti, elektriciteti, uji dhe sistemet bankare. Problemi qëndron në faktin se ato janë tashmë pika të prirura ndaj përcarjes e piraterisë elektronike. Rreziqet që vijnë nga degradimi i mjedisit shpesh i kalojnë kufinj të një shteti. Rreziku më i njohur është ai i rritjes së temperaturës globale, që po shkakton thatësira shkatërruese, përmytje dhe stuhira të forta. Të tjera rreziqe për mjedisin janë dhe ndotja e ajrit dhe ujit, zhdukja e pyjeve dhe biodiversitetit dhe mundësia e futjes së substancave toksike në zinxhirin ushqimor të njeriut.